

Administratë publike në shërbim të qytetarëve



RAPORTI 2016

Prishtina
po bëhet





Vizioni:

Vizioni - Administratë publike në shërbim të qytetarëve, me shërbime inovative dhe të digjitalizuara, me qëllim të lehtësimit por edhe transformimit të jetës së qytetarëve në mënyrë që të bëjnë jetën ashtu siç duan ata.

Misioni - Përgatitja e automatizimit të proceseve të punës dhe të proceseve organizative, si një bazë për zhvillimin e shërbimeve elektronike (digjitale) të reja të administratës publike moderne. Përsosmëri në sigurimin e sistemeve të zgjuara dhe të qëndrueshme të shërbimeve digjitale, që do të sigurojë një cilësi më të lartë të jetës për qytetarët.

Hapja e Komunës për qytetarë

Deri në vitin 2014, Komuna e Prishtinës ishte objekt i myllur për qytetarët. Përgjigjet në pyetjet dhe çështjet që preokuponon jetën e qytetarëve mungonin. Pritjet e gjata, korrupsioni, ngacmimet seksuale në sportele ishin përditshmëri.

Tri vite pas, administrata e Komunës së Prishtinës është shndërruar në administratë në shërbim të qytetarëve, duke:

reduktuar pritjet dhe lehtësuar procedurat për pajisjen me dokumente; eliminuar korrupsionin; ndaluar ngacmimet seksuale; dhënë përgjigje të shpejta dhe të plota në pyetjet dhe kërkesat e të gjithë qytetarëve.

E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me ligj, e cila në Komunën e Prishtinës zbatohet dhe rrespektohet

Për të garantuar këtë të drejtë për informim të saktë dhe të shpejtë, kemi realizuar projektet:

E-Rekrutimi - Mundëson aplikimin 'online' për çdo pozitë të lirë në Komunë, informata rreth aplikantëve, informata për rezultatet e rekrutimit, mundësinë e dërgimit të ankesës 'online' dhe shumë opsione të tjera.

Po ashtu, mund të njoftoheni për drejtoritë, strukturën e të punësuarve, manualin e përgatitur për qytetarë dhe të tjera.

E-shpenzimet – Aplikacioni për telefoni mobile (IOS dhe ANDROID versionet), i cili shkarkohet dhe instalohet në telefonat e mençur mobilë. Në këtë aplikacion paraqiten shpenzimet e Komunës, të ndara në 5 kategori buxhetore, si dhe lajmet më të reja nga Komuna. Pasqyrimet në bazë të kategorive dhe drejtorive janë paraqitur në formë grafike dhe të prezantuara edhe me vlera të shpenzimeve.

Infografikat – Projekt i cili përfshin broshura dhe tabela informuese për Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Kadastrit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Urbanizmit.

Informatat përfshijnë të dhëna se ku duhet të drejtohen qytetarët për problemet apo nevojat e tyre, cilat dokumente u nevojiten për t'u pajisur me çdo lloj të vërtetimit ose dokumentit që lëshon Komuna.

Të tri këto produkte janë të ndërlidhura me implementimin e Planit të Integritetit, të cilin Komuna e Prishtinës së bashku me UNDP-në, e kanë përpiluar në fillim të mandatit qeverisës. Produktet e prezantuara janë të bazuara në objektivat kryesore të planit të integritetit – në efikasitet, efektivitet, transparencë dhe luftim të korruptionit.

E-Kiosku – Komuna e Prishtinës bëhet ndër komunat e para në rajon me instalimin e e-Kioskut. Përmes E-Kioskut, qytetarët mund të pajisen me 5 certifikata të ndryshme, me çmim të njëjtë, në kohë shumë të shkurtë (2-3 min), shtatë ditë në javë për 24 orë. Certifikata "online" –shërbim i shpejtë përmes internetit – për 48 orë certifikata arrin në shtëpi.

Sistemi i pritjes –ka përmirësuar shërbimet e Komunës, ka lehtësuar procesin e marrjes së dokumenteve personale dhe ka ulur kohën e pritjes nga 2-4 orë, në më pak se 5 minuta. Tani të gjitha procedurat për nxjerrjen e dokumenteve kryhen në një sportel. Sistemi i pritjes është zgjeruar në të gjitha drejtoritë të cilat kanë punë me palë.

Kthimi i besimit të qytetarëve në institucione publike përmes transparencës dhe qasjes së lehtë në shërbime komunale.

Çfarëdo informate që ju nevojitet për konkurse apo shpenzime buxhetore, për punën e kryetarit apo të drejtorëve, mund të mbështeteni tek administrata digitale.

Puna jonë në Komunën e Prishtinës është që përmes realizimit të projekteve t'i ofrojmë qytetarëve të gjitha shërbimet dhe informatat e nevojshme të sakta dhe të shpejta. Projektet e realizuara deri më tanë dhe ato në realizim e sipër, kanë bërë që Komunën të jetë në shërbim të qytetarit.

Këtë vit, Komuna e Prishtinës u nderua me mirënjojje për kontribut të veçantë dhe luftë kundër korruptionit nga UNDP-ja, Zyra Zvicerane në Kosovë dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës

Implementimi i kësaj platforme ka ngritur në maksimum nivelin e transparencës në Komunën e Prishtinës.


Platforma Digitale 'OPEN DATA' –Përmes kësaj platforme bëhet pasqyrimi i të gjitha informacioneve të mbledhura nga drejtoritë komunale, me qëllim që këto shënimë të përdoren më tutje në funksion të transparencës së plotë në Komunë, si dhe në funksion të zhvillimit lokal. Në këtë platformë janë të përfshira gjithsej 17 kategori, duke përfshirë edhe punën e kryetarit të Komunës të Prishtinës.



Qytetarët të kënaqur me punën e Komunës së Prishtinës

Rezultatet e anketës të UNDP-së lidhur me punën e pushtetit lokal për regjionin e Prishtinës, tregojnë se kënaqshmëria me pushtetin lokal në Prishtinë është më e lartë për 22.48 pikë, ku në vitin 2012 ishte 7.65 kurse në vitin 2015 është 30.13. Kënaqshmëria rreth performancës së kryetarit të Komunës së Prishtinës është rritur për 11.1% në krahasim me 69.9 %, sa ishte në vitin 2012. Performance e Kuvendit të Komunës së Prishtinës është rritur për 5% nga sa ishte 57.5% në vitin 2012. Performance e Administratës komunale është rritur për 22.2% nga sa ishte 62.2% në vitin 2012.

Komuna e Prishtinës në 6-mujorin e parë 2015, është shpallur komuna më transparente me **70.8%** - Raporti i KDI-së për transparencë



Komuna e Prishtinës është gjithnjë në shërbim të qytetarëve dhe shërbimi më i mirë ofrohet vetëm atëherë kur qytetarët bëhen pjesë aktive e vendimeve tona.

Për këtë arsy, ne çdo herë e më shumë po ofrojmë mundësi për angazhim aktiv dhe të drejtpërdrejtë në politikat lokale.

PRIŠTINAIME

Platforma digitale për pjesëmarrje publike

Kjo platformë është pilot-projekt, i cili është krijuar me ndihmën e OSBE-së dhe iu ofron qytetarëve qasje 'online' dhe mundësi për propozimet e projekteve për lagjet e tyre, si dhe votimin për realizimin e projekteve të propozuara në lagje. Kjo e rrit transparencën dhe e obligon Komunën që të merret me kërkesat konkrete të qytetarëve dhe të planifikojë buxhetin komunal.

ID	Title	Description	Date	Category	Status
1	Propozitë për zgjerim e trapezit të reindit të Dajtit	Analizë - Llogari i Administratorit	2021-06-01 10:00	Propozitë zgjerim	0 - 0
2	Propozitë zgjerim	Analizë - Anonim - Avg.	2021-06-01 10:00	Propozitë zgjerim	0 - 0
3	Propozitë për zgjerim të trapezit (faza përshtatake)	Analizë - Mësim - Trag.	2021-06-01 10:00	Propozitë zgjerim	0 - 0
4	Propozitë për Lëvizje e Hapësise Rrjetore	Analizë - Urazi -	2021-06-01 10:00	Propozitë zgjerim	0 - 0
5	Propozitë - zbatimi i trapezit (faza përshtatake)	Analizë - Urazi -	2021-06-01 10:00	Propozitë zgjerim	0 - 0
6	Propozitë e trapezit Dajtit	Analizë - Urazi -	2021-06-01 10:00	Propozitë zgjerim	0 - 0
7	zgjerim na trapez	Analizë - Urazi -	2021-06-01 10:00	Propozitë zgjerim	0 - 0

E-Inspeksioni – lajmëro parregullsitë

në çdo kohë dhe në çdo vend

Aplikacion digital për telefoni mobile, i cili do të mundësojë që qytetarët të paraqesin parregullsitë që vërejnë, duke i fotografuar dhe dërguar ato në adresën e duhur, siç është Drejtoria e Inspeksionit dhe pastaj informata përcillet në drejtoritë tjera përkatëse.

Krijo Lajmerim

Subjekti *

Zgjidh Subjektin

RREZIK PER SHENDETIN/PRONEN PUBLIKE



NDOTJE E AMBIENTIT



SHKELJE / PENGESA NE KOMUNIKACION



PERGJITHSHME / RENDI KOMUNAL



PYJE / BUJQESI / GJUETI / PESHKIM



NDERTIM



FOTO

Anonimi

DERICO >

Krijo Lajmerim

Subjekti *

Zgjidh Subjektin

Shkakleti Potencial

Perspektivë i Lajmerimit *

Dergo Koordinatal

FOTO

Anonimi

DERICO >

Hapësirat dhe pronat publike janë pasuri e përbashkët dhe për këtë arsyе informatat rreth menaxhimit të tyre janë në interes të të gjithë qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Databaza e digitalizuar për nevoja e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, mundëson evidentimin digjital të të gjitha hapësirave publike të dhëna në shfrytëzim. Pas paraqitjes së kërkesës në Drejtorinë përkatëse dhe pas dhënies në shfrytëzim, mund të informoheni për skadimin e kontratës, emrin e lokalit, emrin e pronarit, çmimin që paguan shfrytëzuesi, si dhe sipërfaqen e lejuar për shfrytëzim.


SHTYP DATABAZËN										
Emri i lokalit	Pronari	Destinimi	Adresa e saktë	Sipërfaqja totale	Hapësira e mbrendshme	Hapësira e jashtme	Vlefshmeria e lejes deri me	Çmimi/m ²	Zona	
DPH Kle Trock	Dukagjin Emini	hotelier	rr „Fehmi Agani”	-	-	53.35	30-Sep-16	8 euro tend 6 euro tavolin	I	
Extrem Pica	Kreshnik Smajlaj	hotelier	rr „Agim Ramadani”	-	-	33 m	30-Sep-16	4.50 dhe 8 euro	II	
NH Half -Cafe	Bashni Blakqori	hotelier	sheshi Nena Terez	-	-	21	30-Sep-16	8 euro tend 6 euro tavolin	I	
SHPK „Moll Caffe”	Faik Fazliu	hoteler	Egrem Qabej	-	-	35	30-Sep-16	35	II	
DPH Te Kitara	Naser Bujupi	hoteler	-	-	-	12	30-Sep-16	8 euro tenda dhe 6 tavolina	I	
shpk Titë	Martin Hajdari	HOTELIER	RR „Z. Komku	-	-	17.70	30-Sep-16	8 euro tend 6 euro tavolina	I	
BI	Ilakrim Gashi	hoteler	sheshi „Zahir Pajaziti”	-	-	5.55 m	30-Sep-16	8 euro tenda dhe 6 euro per tavolina	I	
SHPK „Tavema miqt	Mirsad Rexhepi	Hoteller	sheshi „Nena Tereze”	-	-	12.74	30-Sep-16	8 euro per tenda dhe 6 euro per tavolina ne m	I	

Transparenca e shfrytëzimit të pronave publike do të ngritet në nivelin maksimal.

Digitalizim i pronave publike - Projekti është në fazën e fundit të realizimit.


Duke shfrytëzuar 'Google Maps', qytetarët shumë shpejt do të mund të shikojnë, në çdo moment, statusin e të gjitha pronave publike:

- a janë të lira,
- kush është qiramarrësi,
- për sa vjet është dhënë prona në shfrytëzim,
- çmimi i pronës,
- kur skadon kontrata etj.



SENSORËT PËR MATJEN E NDOTJES SË AJRIT

Implementimi i projektit për matjen e cilësisë së ajrit, që ka për qëllim të mundësojë mbledhjen, azhurnimin dhe përpunimin e rezultateve të monitorimit automatik në kohë reale të cilësisë së ajrit, t'i informojë qytetarët mbi gjendjen momentale të cilësisë së ajrit përmes 10 parametrave matës, si dhe të ofrojë vlerësim rreth masave që duhet të ndërmerren për të ngritur nivelin e cilësisë së ajrit.



Digjitalizimi i plotë i procedurave administrative është bërë me qëllim të procedimit sa më të shpejtë të rasteve, evitimin e parregullsive, shërbime më cilësore, qasje më të lehtë dhe përcjellje më të lehtë të rasteve dhe dërgimi i tyre në instanca të tjera.

Komuna e Prishtinës ka themeluar "Regjistrin e procedurave administrative", ku publikohen të gjitha informatat mbi procedurat që qytetarët marrin nga Komuna. Për secilën procedurë është e detajuar baza ligjore, informacioni dhe dokumentet e nevojshme për të aplikuar, tarifat dhe pagesat për aplikim, si dhe koha e përcaktuar për kthimin e përgjigjes.

Me publikimin e këtij regjistri, Komuna e Prishtinës ofron qasje më të lehtë, më cilësore dhe më efikase në shërbimet komunale, si dhe rrit transparencën ndaj qytetarëve dhe bizneseve.




Në ndarjen e çmimeve "Albanian ICT Awards" për të arriturat në teknologjinë informative dhe kompjuterike për vitin 2015 në kategorinë "Shërbimet Publike", çmimin e parë e fitoi Komuna e Prishtinës, për implementimin e E-Kioskut - shërbimit digjital për nxjerrjen e dokumenteve personale.

Digjitalizimi i procesit të punës në Drejtorinë e Inspeksionit

Për të shtuar efikasitetin e punës dhe për shkak të shpejtësisë së veprimit që kërkonet në terren, por edhe për shkak të shpejtësisë së identifikimit, procedimit të rasteve dhe marrjes së vendimeve, kemi digjitalizuar procesin e punës në Drejtorinë e Inspeksionit. Përmes procesit të digjitalizuar bëhet regjistrimi i lajmërimeve, identifikimi i rasteve, procedimi i rasteve sipas rrjedhës, si dhe mbyllja e rastit apo dërgimi në një instancë tjeter. I gjithë procesi regjistrohet dhe arkivohet.

Digjitalizmi ka lehtësuar punën e inspektoreve, të cilët mund të komunikojnë direkt me sallën operative për të dërguar informacionet e nevojshme sa herë që hasin në parregullsi. Pastaj, informacioni përpunohet tutje nga zyrtari përkatës, dhe në fund mbylljet si rast ose dërgohet në instanca të tjera. Inspektorit në terren i kthehet forma e shkruar e procesverbalit apo vendimit, të cilin e printon dhe ia jep palës në vendngjarje.



Digjitalizim

Transparenca në Drejtorenë e Kulturës

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënisë gjatë procesit të subvencionimit të projekteve në Sektorin e Kulturës, Komuna e Prishtinës ka marrë iniciativë që të digjitalizojë edhe procesin e subvencionimit. Ky proces përfshinë digjitalizimin e plotë të këtij aktiviteti, duke filluar nga

- pranimi i kërkesave / Aplikacioni me projekte,
- komisioni dhe shqyrtimi i kërkesave,
- vendimi për përkrahje apo njoftimi për mospërkrahje,
- monitorimi dhe raportimi për realizimin projekteve


Digjitalizimi i menaxhimit të mbeturinave

Problemi me të cilin përballet Komuna e Prishtinës, është sasia e madhe e mbeturinave në shporta dhe kontejnerë të vendosur në pjesë të ndryshme të qytetit. Deri më tani ne e kemi pasur të vështirë të monitorojmë punën e kompanive të pastrimit rreth zbrazjes së shportave dhe kontejnerëve, dhe si rezultat kemi pasur një pamje jo të këndshme në pjesë të qytetit.

Për të monitoruar sa më mirë punën e kompanive të pastrimit, në mënyrë që shportat dhe kontejnerët të pastrohen dhe zbrazen sa herë që paraqitet nevoja, Komuna e Prishtinë ka filluar projektin për digjitalizimin e menaxhimit të mbeturinave.

Me realizimin e këtij projekti, Komuna e Prishtinës do të ketë mundësi që në kohë reale të monitorojë punën e kompanive të pastrimit dhe të kërkojë përgjegjësi prej tyre për mos kryerjen e punëve të tyre.

Përmes këtij projekti do të vendoset nga një çip digjital në çdo shportë apo kontejner të mbeturinave, i cili do të mundësojë monitorim real dhe përcillet në hartë se ku janë pastruar mbeturinat dhe ku nuk janë pastruar.




Prokurimi digjital

Sistemi për menaxhimin e tenderëve dhe prokurimit garanton kontroll të buxhetit vjetor, linjave buxhetore, procesim të tenderëve dhe kontratave (duke përfshirë pagesat). Kjo bëhet përmes makinës së rrjedhës së punës plotësisht të konfigurueshme, dhe siguron punë më të mirë në një ambient plotësisht bashkëpunues dhe kontrollues.


Të gjithë hapat në procesin e tenderimit janë të pajisur me funksione specifike të dizajnuara për menaxhimin e çdo hapi të procesit, nga buxhetimi, krijimi i strategjisë së kontratave, paraqitja dhe dhënia eventuale e kontratave të punës, duke përfshirë edhe etapat pas dhënieve së kontratës, siç është kontrollimi i kohës së pagesave të faturave.

Projekti është në fazën finale të testimit nga punëtorët.



Digjitalizimi i stacioneve të autobusëve

Sistemi për informim të pasagjerëve për transport publik, është një projekt që ka për qëllim shfaqjen dhe monitorimin në kohë reale të autobusëve urbanë në komunën e Prishtinës. Ideja e këtij projekti është montimi i moduleve hardverike në autobusë, që dërgojnë të dhëna të vazhdueshme për vendndodhjen e autobusëve. Këto të dhëna dërgohen në një server, i cili pas përpunimit të tyre i bën të qasshme të dhënat në aplikacione mobile përkatëse. Qytetarët e komunës së Prishtinës do të kenë mundësinë që në telefonat e tyre personal, të instalojnë aplikacionet që shfaqin në kohë reale pozitën gjeografike të autobusit dhe një kohë të përafërt për të cilën autobusi mund të arrijë në stacionin e caktuar.



Qasja në dokumente zyrtare

Digjitalizimi i qasjes në dokumentet zyrtare, mundëson që kërkesat për qasje në dokumente zyrtare të parashtronët në mënyrë digitale. Prosesi është plotësisht i automatizuar dhe pas përgatitjes së dokumenteve të kérkuara, Komuna përmes e-mailit e informon qytetarin për të térhequr dokumentin e kérkuar.

E-FATURA

Nga marsi 2016, tatimpaguesve, përmes shërbimit elektronik për tatimin në pronë "E-Fatura", mundësohet marrja e faturës, përcjellja e gjendjes, si dhe bërrja e pagesës së tatimit në pronë në pikën më të afërt, në Postë apo në Bankë. Përmes përdorimit të këtij shërbimi elektronik, tatimpaguesit kursejnë kohën dhe koston dhe po ashtu, mundë ta përcjellin gjendjen në çdo kohë.

VOTIMI DIGJITAL

Tashmë, në Kuvendin e Komunës së Prishtinës nuk votohet me ngritje të dorës, por përmes votimi digital të instaluar në sallën e Kuvendit komunal.


PARKU I TË MARTUARVE

Projekt i ri, i cili do të realizohet nga Zyra e Gjendjes Civile. Çdo qift i sapomartuar do të ketë mundësi të mbjellë pemën e tyre në sipërfaqen e caktuar për këtë aktivitet.

Qëllimi i projektit është të bëjë:

- 1. Zgjerimin e hapësirave të gjelbra në komunën e Prishtinës;**
- 2. Krijimin e një tradite te qytetarët e Prishtinës;**
- 3. Inkurajimin dhe aktivizimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës në mbrojtje të ambientit;**
- 4. Plotësimin e një kriteri të rëndësishëm të dokumentit të nënshkruar në Paris (COP21) mbi ndryshimet klimatike.**

Secili qift i cili dëshiron të mbjellë drurin e të sapomartuarve, do të marrë edhe aplikacionin e telefonisë mobile për ta përcjellë dhe për tu përkujdesur për atë dru.





Prishtina
po bëhet